



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

---

**AD/GJTHGJA.nr. 05/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi O. C. avokat në Pejë, ndaj gjyqtarit D. B., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 04 dhjetor 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Refuzohet** ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati O. C., ndaj gjyqtarit D. B., si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, O. C. avokat në Pejë, me datën 12 nëntor 2024, e ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën me emërtimin “*ankesë*” ndaj gjyqtarit D. B., e që ka të bëjë me vendimin e gjyqtarit në lëndën C.nr.1535/22, në të cilën avokati O. C. është përfaqësues i paditësit.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr. 05/24 me datën 12 nëntor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr. 05/24 të datës 12 nëntor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi, O. C. avokat në Pejë, me datë 12 nëntor 2024, ka paraqitur ankesë për shkelje disiplinore të bëra nga gjyqtari D. B., pasi që me datë 18.10.2024 në lëndën C.nr. 1535/22 ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenit 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me arsyetimin se pasi që

paraprakisht avokati ka ushtruar një ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit lidhur me mospranim të autorizimit për përfaqësim në gjykatë (i cili autorizim ka qenë valid, edhe pse paraprakisht i njëjti gjyqtar ka pranuar këtë autorizim si valid duke vendosur meritorisht lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me datë 14.10.2024 dhe e refuzon propozimin). Me qëllim të prolongimit të çështjes për shkak të ankesës paraprake, gjyqtari ka marr aktvendim të paligjshëm C.nr.1535/22 me datë 18.10.2024, me të cilën ka hedhur poshtë padinë e paditësit dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë, me arsyetimin se autorizimi nga Republika e Malit të Zi nuk pranohet nga gjykata dhe pala nuk ka vepruar në kërkesën e gjykatës për vërtetimin e autorizimit në Kosovë, e krejt kjo në kundërshtim me normat imperative ligjore, LPK-së, profesionalizmit në punë, respektimin e të drejtave të palës në procedurë, e garantuar me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe qasjen në gjykatë duke e anashkaluar edhe praktiken e standardizuar me të cilën klienti – pala i cili jeton jashtë Republikës së Kosovës ka të drejtë të angazhojë avokat kudo që gjendet në botë, pa obligimin që të gjendet në Kosovë, në veçanti nga zyra noteriale e shteteve me të cilat shtete, Republika e Kosovës ka krijuara praktiken e reciprociteti dhe njohje reciproke dhe bashkëpunim të plotë juridik. Duke pasur parasysh edhe adresën e palës paditëse të dhënë në autorizim të njëjtë, nuk i ka informuar dhe nuk i ka ofruar mundësinë që të inkuadrohet personalisht në këtë lëndë, ashtu që veprimet e gjyqtarit që nga fillimi i procedurës në këtë rast hedhin dyshime në objektivitetin e tij, për çka edhe paraprakisht kemi kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nga vendimmarrja në këtë lëndë. Andaj, ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës që në bazë të kompetencave të zbatoj procedurën sipas dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe të njoftoj Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe kryesuesin A. Z. .

Gjyqtari D. B., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit, ka deklaruar se me aktvendimin e datës 10.09.2024 e ka detyruar avokatin O. C. që të paraqes autorizimin valid të dhënë nga paditësi – propozuesi, të cilin autorizim e ka kërkuar t’i dorëzohet i vërtetuar nga organi noterial në Republikën e Kosovës, në rastet kur autorizimi nuk i plotëson kushtet ligjore, pavarësisht se ku është përpiluar. Gjyqtari këtë obligim të dhënë nga gjykata e ka mbështetur në nenin 92 par. 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin parashihet *“Po qe se dyshohet në vërtetësinë e prokurës, gjykata mund të vendosë me aktvendim që të paraqitet prokura e verifikuar. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi”*. Gjyqtari në deklaratën e tij ka shtuar se avokati O. C. me datë 17.09.2024, ka dorëzuar parashtresën me autorizimin e noterizuar, jo nga organet kompetente të Republikës së Kosovës, por nga noteri kompetent në Republikën e Malit të Zi, si dhe autorizimi i dorëzuar ka qenë në versionin kopje. Tutje ka shtuar *“Marr parasysh se i njëjti nuk ka respektuar detyrimin e dhënë nga gjykata, kjo e fundit me datë 18.10.2024, ka vendosur duke e hedhur padinë dhe propozimin si të palejueshme, me arsyetimin sikurse në aktvendimin C.nr.1535/22 të datës 18.10.2024, me të drejtë në ankesë. Andaj, veprimet e gjyqtarit janë marr duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe se ankesa e parashtruar në drejtim të pretendimeve për shkelje të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të*

*Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është e pabazuar, pa specifikuar shkelje konkrete*”. Gjyqtari e ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe ankesën si të pabazuar.

Kryetari i gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtarit, si dhe shkresave të lëndës C.nr.1535/22, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenin 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar për faktin se bazuar në aktvendimin C.nr.1535/22 të datës 18 tetor 2024, gjyqtari me rastin e vendosjes sipas këtij aktvendimi, tek baza ligjore e arsytimit të aktvendimit i ka cekur dispozitat ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore të cilat i ka zbatuar me rastin e vendosjes në këtë çështje dhe si të tilla nuk përbëjnë shkelje disiplinore ashtu siç pretendon ankuesi. Kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast të dispozitave ligjore të aplikuara me rastin e marrjes së aktvendimit C.nr.1535/22, janë gjykatat e instancave më të larta sipas mjeteve juridike, pasi që vendimmarrja nuk hynë në domenin e shkeljeve disiplinore ashtu siç është e paraparë me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, mirëpo i nënshtrohet kontrollit nga gjykatat më të larta sipas mjeteve juridike.

Pretendimet e ankuesit se paraprakisht avokati–ankuesi ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit lidhur me mospranimin e autorizimit për përfaqësim në gjykatë, për shkak të kësaj ankesë paraprake gjyqtari ka marr aktvendim të paligjshëm më të cilin e ka hedhur poshtë padinë e paditësit dhe propozimin për masën e sigurisë me arsytimin se autorizimi nga Republika e Malit të Zi nuk pranohet nga gjykata, janë vlerësuar dhe analizuar dhe kryetari i gjykatës ka konstatuar se ky pretendim është i pa bazuar. Kjo argumentohet nga fakti se gjyqtari me aktvendimin e datës 10.09.2024 e ka detyruar avokatin–ankuesin që ta paraqes autorizimin valid, i cili është kërkuar që të jetë i vërtetuar nga organi noterial i Republikës së Kosovës. Avokati–ankuesi me datë 17.09.2024, duke vepruar sipas kërkesë së gjykatës ka dorëzuar parashtrësën së bashku me autorizimin e përpiluar tek noteri në Republikën e Malit të Zi në versionin kopje dhe jo ashtu siç ka kërkuar gjyqtari me aktvendim që të autorizimi të jetë i vërtetuar nga organi noterial i Republikës së Kosovës. Pas këtij veprimi të avokatit–ankuesit gjyqtari ka nxjerr aktvendimin C.nr.1535/22 me datë 18.10.2024, me të cilin e ka hedhur padinë. Ky veprim i gjyqtarit është marr duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe si i tillë sipas vlerësimit të kryetarit të gjykatës nuk përbën shkelje disiplinore, por mund të trajtohet nga Gjykata e Apelit, si gjykatë e instancës më të lartë sipas mjeteve juridike, pasi që lidhur më këtë lëndë dhe pothuajse mbi të njëjtën bazë edhe njëherë ankuesi ka paraqitur ankesë për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit dhe se e njëjta i është refuzuar me aktvendimin AD/GJTHGJA.nr. 01/24, të datës 25 shtator 2024.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe deklaratën e gjyqtarit vërtetohet se gjyqtari para se të bie këtë aktvendim, në bazë të nenit 92 par. 3 të Ligji për Procedurën Kontestimore, ka kërkuar që gjykatës

t'i paraqitet prokura e verifikuar dhe se vetëm pasi ankuesi nuk ka vepruar sipas kërkesës së gjykatës, është marr aktvendimin për hedhjen e padisë, pra nga këto konstatohet se gjyqtari paraprakisht e ka njoftuar avokatin–ankuesin me pasojat nëse nuk veprohet sipas kërkesës, ashtu që në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, siç pretendon ankuesi.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, trajtim i pa barabartë i palëve në procedurë të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari D. B., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD/GJTHGJA.nr. 05/24, datë 04 dhjetor 2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Nikollë Komani**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Parashtruesit të ankesës*
- 3. Gjyqtarit*